MARRËVESHJE
PËR
BASHKËPRODHIM TË FILMIT
NDËRMJET
QEVERISË SË SHTETIT TË IZRAELIT
DHE
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Qeveria e Shtetit të Izraelit dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, në vijim të referuara si "Palët";

Duke pasur parasysh faktin se bashkëpunimi i ndërsjellë mund t'i shërbejë zhvillimit të prodhimit të filmit dhe të inkurajojë zhvillimin e mëtejshëm të lidhjeve kulturore dhe teknologjike midis dy vendeve;

Duke marrë parasysh se bashkëprodhimi mund t'u kontribuoj industrive të filmit të vendeve përkatëse, dhe të kontribuojë në rritjen ekonomike të industrisë së prodhimit dhe shpërndarjes së filmit, televizionit, videove dhe mediave të reja në Kosovë dhe Izrael;

Duke vënë në dukje vendimin e tyre të ndërsjellë për të krijuar një kornizë për inkurajimin e të gjithë prodhimit mediatik audio-vizual, veçanërisht bashkëprodhimin e filmave;
Bien dakord si më poshtë:

Neni 1
PËRKUFIZIMET

Për qëllime të kësaj Marrëveshjeje:

(1) "**bashkëprodhim**" ose "**film në bashkëprodhim**" do të thotë një vepër kinematografike, me ose pa tinguj shoqërues, pavarësisht nga gjatësia ose zhanri, përfshirë filmat artistik, të animuar dhe dokumentarët, të krijuar nga bashkëproducenti kosovar dhe bashkëproducenti izraelit, të prodhuar në çfarëdo formati, për shpërndarje nëpërmjet çdo vendi ose mediumi, përfshirë teatrot, televizionin, internetin, videokasetën, videodiskun, CD-ROM-in ose çdo mjet të ngjashëm, përfshirë format e ardhshme të prodhimit dhe shpërndarjes kinematografike;
(2) "**Bashkëproducent kosovar**" nënkupton personin ose subjektet kosovare nga të cilët janë kryer aranzhimet e nevojshme për realizimin e filmit;

(3) "**Bashkëproducent izraelit**" nënkupton personin ose subjektet izraelite nga të cilët janë kryer aranzhimet e nevojshme për realizimin e filmit;

(4) "**Autoritetet Kompetente**" nënkuptojnë të dy Autoritetet Kompetente përgjegjëse për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje ose secilin Autoritet Kompetent në lidhje me vendin e vet, sipas rastit. Autoritetet kompetente janë:
- Për palën izraelite: Ministria e Kulturës dhe Sportit ose përfaqësuesit e saj;
- Për palën kosovare: Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Qendra Kinematografike e Kosovës

Neni 2
PËRFITIMET

(1) Filmat që do të bashkëprodhohen në përputhje me këtë Marrëveshje nga të dy vendet duhet të miratohen nga autoritetet kompetente.

(2) Çdo bashkëprodhim i prodhuar në zbatim të kësaj Marrëveshjeje do të konsiderohet nga Autoritetet Kompetente si një film kombëtar, që i nënshtrohet, përkatësisht, legjislacionit vendas të secilës palë. Këto bashkëprodhime do të gëzojnë të drejtën e përfitimeve të cilat i gëzon industria e prodhimit të filmit në bazë të legjislacionit vendas të secilës palë ose atyre përfitimeve që mund të dekretohen nga secila palë. Këto përfitime i takojnë vetëm bashkëproducentit të një vendi që i jep ato.

(3) Mospërmbushja e kushteve nga ana e bashkëproducentit të ndonjërës Palë, sipas të cilave ajo Palë ka miratuar një bashkëprodhim, ose shkelja materiale e marrëveshjes së bashkëprodhimit nga bashkëproducenti i ndonjërës Palë, mund të shkaktoj revokimin e statusit të bashkëprodhimit nga ajo Palë, lidhur me prodhimin dhe të drejtat dhe përfitimet të shoqëruesit.

Neni 3
MIRATIMI I PROJEKTIT

(1) Në mënyrë që të kualifikohen për përfitimet e bashkëprodhimit, bashkëproducentët duhet të ofrojnë dëshmi se ata kanë organizimin e duhur teknik, mbështetjen financiare, pozitën e njohur profesionale dhe kualifikimet për ta përmbyllur prodhimin në mënyrë të suksesshme.

(2) Miratimi nuk do t'i jepet atij projekti ku bashkëproducentët janë të lidhur me menaxhim ose kontroll të përbashkët, përveç deri në masën kur një shoqatë e tillë është krijuar konkretisht me qëllim të vetë filmit bashkëprodhues.

Neni 4
XHIRIMET

(1) Filmat në bashkëprodhim realizohen, përpunohen, dublohen ose titrohen, deri në krijimin e kopjes së parë publike në vendet e bashkëproducentëve pjesëmarrës. Megjithatë, nëse skenari ose subjekti i filmit e kërkon, lokacioni i xhirimit, jashtë ose brenda, në një vend që nuk merr pjesë në bashkëprodhim,

mund të autorizohet nga Autoritetet Kompetente. Në mënyrë të ngjashme, nëse shërbimet e përpunimit, dublimit ose titrave të cilësisë së kënaqshme nuk janë të disponueshme në vendin pjesëmarrës në bashkëprodhim, Autoritetet Kompetente mund të autorizojnë blerjen e shërbimeve të tilla nga një furnizues në një vend të tretë.

(2) Producentët, autorët, skenaristët, interpretuesit, regjisorët, profesionistët dhe teknikët që marrin pjesë në bashkëprodhime, duhet të jenë shtetas ose banorë të përhershëm të Republikës së Kosovës ose të Shtetit të Izraelit në përputhje me legjislacionin respektiv vendas të Palëve.

(3) Nëse bashkëprodhimi e kërkon, pjesëmarrja e profesionistëve që nuk plotësojnë kushtet e parashikuara në paragrafin (2) mund të lejohet, në rrethana të jashtëzakonshme, dhe me miratimin e Autoriteteve Kompetente.

(4) Përdorimi i çdo gjuhe tjetër në një bashkëprodhim, që dallon nga gjuhët e lejuara sipas legjislacionit të Palëve, mund t'i shtohet bashkëprodhimit nëse këtë e kërkon skenari.

Neni 5
PJESËMARRËSIT

(1) Kontributet përkatëse të producentëve të të dy vendeve mund të variojnë nga njëzet (20) në tetëdhjetë (80) për qind për çdo film në bashkëprodhim. Gjithashtu, bashkëproducentëve do t'u kërkohet të japin një kontribut efektiv teknik dhe krijues, në proporcion me investimin e tyre financiar në filmin në bashkëprodhim. Kontributi teknik dhe kreativ duhet të përbëhet nga pjesa e kombinuar e autorëve, interpretuesve, personelit tekniko-prodhues, laboratorëve dhe objekteve.

Çdo përjashtim nga parimet e sipërpërmendura duhet të miratohet nga Autoritetet Kompetente, të cilat, në raste të veçanta, mund të autorizojnë që kontributet përkatëse nga producentët e të dy vendeve të sillen nga dhjetë (10) në nëntëdhjetë (90) për qind.

(2) Në rast se bashkëproducenti kosovar ose bashkëproducenti izraelit përbëhet nga disa kompani të produkcionit, kontributi i secilës kompani nuk duhet të jetë më i vogël se pesë (5) për qind e buxhetit të përgjithshëm të filmit në bashkëprodhim.

(3) Në rast se një prodhues nga një vend i tretë autorizohet të marrë pjesë në bashkëprodhim, kontributi i tij nuk duhet të jetë më i vogël se dhjetë (10) për qind. Në rast se bashkëproducenti nga një vend i tretë përbëhet nga disa kompani prodhuese, kontributi i secilës kompani nuk duhet të jetë më i vogël se pesë (5) për qind e buxhetit të përgjithshëm të filmit në bashkëprodhim.

Neni 6
GJUHËT

(1) Palët do të inkurajojnë bashkëprodhimet që plotësojnë standardet teknike ndërkombëtare të pranuara përgjithësisht.

(2) Kushtet për miratimin e filmave në bashkëprodhim dakordësohen bashkërisht nga Autoritetet Kompetente, rast pas rasti, duke iu nënshtruar dispozitave të kësaj Marrëveshjeje dhe legjislacionit të brendshëm përkatës të Palëve.

Neni 7
KONTRIBUTI I PRODUCENTËVE

(1) Bashkëproducentët sigurohen që në një bashkëprodhim, të drejtat e pronësisë intelektuale që nuk janë në pronësi të tyre, do të jenë të disponueshme për ta nëpërmjet marrëveshjeve të licencës sa për të përmbushur objektivat e kësaj Marrëveshjeje, siç përcaktohet në par. 3(a) të Aneksit.

(2) Ndarja e të drejtave të pronësisë intelektuale në një film në bashkëprodhim, përfshirë pronësinë dhe licencimin e tij, do të bëhet me kontratën e bashkëprodhimit.

(3) Secili bashkëproducent do të ketë qasje të lirë në të gjitha materialet origjinale të bashkëprodhimit dhe të drejtën për të kopjuar ose printuar ato, por jo të drejtën për shfrytëzim ose caktim të të drejtave të pronësisë intelektuale në materialet e përmendura, përveç siç përcaktohet nga bashkëproducentët në kontratën e bashkëprodhimit.

(4) Secili bashkëproducent do të jetë pronar në bazë të përbashkët të kopjes fizike të negativit origjinal ose mediumit tjetër të regjistrimit në të cilin është bërë bashkëprodhimi kryesor, duke mos përfshirë asnjë të drejtë të pronësisë intelektuale që mund të përfshihet në kopjen fizike të përmendur, përveç siç përcaktohet nga bashkëproducentët në kontratën e bashkëprodhimit.

(5) Kur bashkëprodhimi bëhet në një negativ filmi, negativi do të zhvillohet në një laborator të përzgjedhur bashkë nga bashkëproducentët dhe do të depozitohet aty, me një emër të dakordësuar.

Neni 8

Palët do të lehtësojnë hyrjen e përkohshme dhe eksportimin e serishëm të çdo pajisjeje filmike të nevojshme për prodhimin e filmave të bashkëprodhimit sipas kësaj Marrëveshjeje, në varësi të legjislacionit të tyre vendor përkatës. Secila Palë do të bëjë të maksimumin, sipas legjislacionit të saj të brendshëm, për të lejuar personelin krijues dhe teknik të Palës tjetër të hyjë dhe të qëndrojë në territorin e saj me qëllim të pjesëmarrjes në prodhimin e filmave në bashkëprodhim.

Neni 9

Miratimi i propozimit për bashkëprodhimin e një filmi nga Autoritetet Kompetente, nuk nënkupton asnjë leje ose autorizim për të shfaqur ose shpërndarë filmin e prodhuar.

Neni 10

(1) Nëse filmi i bashkëprodhuar lançohet në tregun e vendit që ka rregulla kuotash në lidhje me të dyja Palët, ai do të përfshihet në kuotën e vendit që është bashkëproducent që ka pjesën më të madhe. Në rast se kontributet e bashkëproducentit janë të barabarta, bashkëprodhimi do të përfshihet në kuotën e vendit shtetas ose banor i përhershëm i të cilit është regjisori i bashkëprodhimit.

(2) Nëse një film i bashkëprodhuar tregtohet në një vend që ka rregullore mbi kuotat në lidhje me ndonjërën nga Palët, filmi i bashkëprodhuar do të tregtohet nga Pala në lidhje me të cilën nuk ka kuotë.

(3) Në rast se një film i bashkëprodhuar tregtohet në një vend që ka rregullore për kuotat në lidhje me njërën ose të dyja Palët, Autoritetet Kompetente mund të bien dakord për marrëveshje në lidhje me rregulloren për kuota, që ndryshojnë nga ato të përcaktuara në paragrafët 1 dhe 2 të këtij neni.

(4) Për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me marketingun ose eksportin e një filmi të bashkëprodhuar, secila palë do t'i japë filmit të bashkëprodhuar të njëjtin status dhe trajtim si produkt vendas, që i nënshtrohet legjislacionit të tyre përkatës të brendshëm.

Neni 11

(1) Të gjithë filmat e bashkëprodhuar do të identifikohen si bashkëprodukcion Kosovar- Izraelit ose Izraelit - Kosovar.

(2) Identifikimi i tillë do të shfaqet në një titull të veçantë të kreditit, në të gjitha materialet reklamuese dhe promovuese komerciale dhe sa herë që filmat e bashkëprodhuar shfaqen në ndonj shfaqje publike.

Neni 12

Autoritetet Kompetente do të veprojnë në përputhje me Rregulloren e Procedurës të bashkangjitur në Aneksin e kësaj Marrëveshjeje, që përbën pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje, por në ndonjë rast të caktuar mund të autorizojnë bashkërisht bashkëproducentët që të veprojnë në përputhje me rregullat ad hoc të cilat ata i miratojnë.

Neni 13

(1) Palët mund të krijojnë një Komision të Përbashkët, me numër të barabartë përfaqësuesish nga të dyja vendet. Komisioni i Përbashkët do të takohet, kur është e nevojshme, sa në Prishtinë dhe herëve të tjera në Jerusalem.

(2) Komisioni i Përbashkët, në mes tjerash do të bëjë:
- Shqyrtimin e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.
- Konstatoj nëse është arritur ekuilibri i përgjithshëm i bashkëprodhimit, duke marrë parasysh numrin e bashkëprodhimeve, përqindjen dhe shumën totale të investimeve dhe të kontributeve artistike dhe teknike. Nëse jo, atëherë Komisioni do të përcaktojë masat që konsiderohen të nevojshme për të vendosur një ekuilibër të tillë.
- Rekomandojë mjetet për përmirësimin e përgjithshëm të bashkëpunimit në bashkëprodhimin e filmit ndërmjet producentëve kosovarë dhe izraelitë.
- T'u rekomandojë autoriteteve kompetente ndryshime në këtë Marrëveshje.

(3) Për anëtarët e Komisionit të Përbashkët Palët duhet të dakordësohen përmes kanaleve diplomatike.

Neni 14

Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me shkrim me pëlqimin e ndërsjellë të Palëve. Çdo modifikim i Marrëveshjes ose i aneksit të bashkëngjitur do të ndjekë të njëjtat procedura për hyrje në fuqi, siç parashihet me nenin 16.

Neni 15

Çdo mosmarrëveshje ndërmjet Palëve që mund të rrjedh si rezultat i zbatimit të kësaj Marrëveshjeje, do të zgjidhet nëpërmjet kanaleve diplomatike.


Neni 16

(1) Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në datën e notës së dytë diplomatike me të cilën Palët njoftojnë njëra-tjetrën se procedurat e tyre të brendshme ligjore për hyrjen e saj në fuqi janë respektuar.


(2) Kjo Marrëveshje do të jetë e vlefshme për një periudhë pesë (5) vjeçare dhe do të zgjatet automatikisht për periudha shtesë prej pesë (5) vjetësh secila, përveç nëse është shkëputur nga ndonjëra Palë, ku i është dhënë të paktën gjashtë (6) muaj njoftim me shkrim Palës tjetër për qëllimin e saj për të shkëputur Marrëveshjen.

(3) Bashkëprodhimet që janë miratuar nga Autoritetet Kompetente dhe që janë duke vazhduar në momentin e njoftimit për ndërprerjen e kësaj Marrëveshjeje nga cilado Palë, do të vazhdojnë të përfitojnë plotësisht nga dispozitat e kësaj Marrëveshjeje deri në përfundimin e tyre.

Nënshkruar në Jerusalem më 9 May, 2022 që korrespondon me 8 të Sivan, 5782, në katër kopje origjinale në gjuhën shqipe, serbe, hebraike dhe angleze, njëlloj autentike. Në rast mospërputhjeve do të mbizotërojë dokumenti në gjuhën angleze.



Për Qeverinë e Shtetit të Izraelit



Për Qeverinë e Republikës së Kosovës

ANEKSI
RREGULLAT E PROCEDURËS

1. Aplikimet për kualifikimin e një filmi për përfitime të bashkëproduksionit duhet të dorëzohen njëkohësisht pranë Autoriteteve Kompetente të paktën gjashtëdhjetë (60) ditë para fillimit të xhirimeve ose animacionit kryesor të filmit.

2. Autoritetet kompetente do të njoftojnë njëra-tjetrën për vendimin e tyre në lidhje me çdo aplikim të tillë për bashkëprodhim brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e dorëzimit të dokumentacionit të plotë të listuar në aneksin e kësaj Marrëveshjeje.

3. Aplikimet duhet të shoqërohen nga dokumentet e mëposhtme në njërën nga gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës dhe në gjuhën angleze dhe në gjuhën hebraike ose angleze për shtetin e Izraelit:

   a. Një dëshmi e marrëveshjes së licencës, për sa i përket të drejtave të pronësisë intelektuale të çfarëdo lloji, duke përfshirë në veçanti të drejtat e autorit dhe të drejtat e përafërta ("të drejtat e përafërta" do të nënkuptohen se përfshijnë, ndër të tjera, të drejtat morale, të drejtat e interpretuesit, të drejtat e prodhuesve të fonogrameve dhe të drejtat e transmetimit), të përfshira në një bashkëprodhim ose që lindin nga ai, deri në atë masë të mjaftueshme për qëllimet e përmbushjes së objektivave të kontratës së bashkëprodhimit, përfshirë marrëveshjet e ndërsjella tregtare mes vendeve për performancën publike, shpërndarjen, transmetimin, vënien në dispozicion nëpërmjet internetit ose përmes formave të tjera, dhe shitjen ose dhënien me qira të kopjeve fizike ose elektronike të bashkëprodhimit në territoret e vendeve të origjinës së Palëve, si dhe në vendet e treta, dhe duke përfshirë sigurimin e të drejtës së autorit dhe të drejtave të përafërta në lidhje me çdo vepër letrare, dramatike, muzikore ose artistike e cila është përshtatur nga aplikuesi për qëllime të bashkëprodhimit;

   b. Kontrata e nënshkruar e bashkëprodhimit, e cila i nënshtrohet miratimit të Autoriteteve Kompetente.

4. Kontrata e bashkëprodhimit duhet të parashikojë çështjet e mëposhtme:

   a. Titullin e filmit, edhe nëse ai është i përkohshëm;
   b. Emrin e shkrimtarit ose të personit përgjegjës për përshtatjen e temës, nëse ajo është nxjerrë nga ndonj burim letrar;
   c. Emrin e regjisorit (një klauzolë sigurie është e lejuar për zëvendësimin e tij, nëse është e nevojshme);
   d. Një përmbledhje të filmit;
   e. Buxhetin e filmit;
   f. Planin për financimin e filmit;
   g. Shumën e kontributeve financiare të bashkëproducentëve;
   h. Aktivitetet financiare të secilit producent për sa i takon ndarjes së përqindjes së shpenzimeve në lidhje me kostot e zhvillimit, përpunimit, produksionit dhe post-prodhimit deri në krijimin e versionit fillestar të filmit.

i. Shpërndarjen e të ardhurave dhe përfitimeve duke përfshirë ndarjen ose vendosjen e çmimeve në treg;
j. Pjesëmarrjen përkatëse të bashkëproducentëve në çdo kosto që tejkalon buxhetin ose në përfitimet nga çdo kursim në koston e prodhimit;
k. Ndarjen e të drejtave të pronësisë intelektuale në një film në bashkëprodhim, përfshirë pronësinë dhe licencimin e tij.
l. Një klauzolë në kontratë duhet të pranoj se miratimi i filmit, duke i dhënë atij të drejtën për përfitime sipas marrëveshjes, nuk i detyron Autoritetet Kompetente të asnjërës Palë të lejojnë shfaqjen publike të filmit. Në të njëjtën mënyrë, kontrata duhet të vendos kushtet e një marrëveshjeje financiare ndërmjet bashkëproducentëve në rast se Autoritetet Kompetente të ndonjërës nga Palët refuzojnë të lejojnë shfaqjen publike të filmit në ndonjërin nga vendet ose në vendet e treta.
m. Shkeljen e kontratës së bashkëprodhimit;
n. Një klauzolë që kërkon që bashkëproducenti kryesor të lidhë një polic sigurimi që mbulon të gjitha rreziqet e prodhimit;
o. Datën e përafërt të fillimit të xhirimeve;
p. Listën e pajisjeve të nevojshme (teknike, artistike ose të tjera) dhe personelit, përfshirë kombësinë e personelit dhe rolet që duhet të luajnë interpretuesit;
q. Orarin e produkcionit;
r. Një marrëveshje shpërndarjeje, nëse një e tillë është lidhur;
s. Mënyrën se si bashkëprodhimi do të futet në festivalet ndërkombëtare;
t. Dispozitat e tjera të kërkuara nga Autoritetet Kompetente.

5. Bashkëproducentët do të ofrojnë çdo dokumentacion dhe informacion tjetër, që Autoritetet Kompetente e gjykojnë të nevojshme për ta proceduar kërkesën e bashkëprodhimit ose për të monitoruar bashkëprodhimin ose ekzekutimin e marrëveshjes së bashkëprodhimit.

6. Dispozitat materiale në kontratën origjinale të bashkëprodhimit mund të ndryshohen në varësi të miratimit paraprak nga Autoritetet Kompetente.

7. Zëvendësimi i një bashkëproducenti i nënshtrohet miratimit paraprak nga Autoritetet Kompetente.

8. Producenti nga një vend i tretë mund të marrë pjesë në bashkëprodhim me pëlqimin e producentëve kosovarë dhe izraelitë. Kontributi i tij mund të jetë jo më shumë se tridhjetë (30) për qind e buxhetit të përgjithshëm të filmit në bashkëprodhim.